



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



KOMUNAT TRANSPARENTE, EFEKTIVE DHE LLOGARIDHËNËSE (USAID TEAM)  
PLATFORMA CIVIKOS

## **Ftesë për aplikim: Njohja e kompetencave në monitorim të prokurimit publik nga Civikos në kuadër të projektit të USAID Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse**

Civikos në kuadër të projektit të USAID Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse hap thirrjen për përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, që veprojnë në nivel lokal që punojnë në fushën e monitorimit të prokurimit publik, që të përfitojnë nga mundësia e njohjes së kompetencave në fushën e monitorimit të prokurimit publik për të gjithë individët të cilën kanë përvojë dhe janë të angazhuar në monitorim të prokurimit publik në nivel lokal.

Civikos do të formojnë një komision të përbërë nga ekspert të prokurimit publik nga shoqëria civile, gazetar, dhe ekspert të jashtëm të prokurimit për të bërë vlerësimin e aplikacioneve dhe të testit.

Pas vlerësimit të aplikacionit dhe rezultatit të testit, për pjesëmarrësit do të lëshohet një certifikatë për njohje të kompetencës, që dëshmon se aplikanti/ja ka njohuri në monitorim të prokurimit publik.

**Civikos do të ofroj trajnim dy ditor në monitorim të prokurimit publik për të gjithë kandidatët e interesuar para procesit të testimit.**

Të gjithë individët të cilët kanë marrë pjesë në punëtoritë e zhvilluara në kuadër të projektit TEAM gjatë vitit 2019 (punëtori mbi mësimin e aplikueshëm), dhe kanë përfunduar me sukses punëtoritë deri në përfundim të raporteve të gjeturave si dhe ata të cilët kanë marrë pjesë gjatë vitit 2020 dhe janë autor të raporteve të gjeturave në monitorim të prokurimit publik nuk kanë nevojë për aplikim pasi do të njihen njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë këtij procesi dhe do të pajisen me certifikatën e kompetencës në monitorim të prokurimit publik.

Të gjithë individët e interesuar të cilën dëshirojnë të përfitojnë nga kjo mundësi ***mund të aplikojnë deri me datën 17.10.2021*** duke plotësuar këtë formë: <https://forms.gle/njBB6wTgo2TpVgd97>

Pas përfundimit të testimit, në rast të kalimit të suksesshëm të testit Civikos do të lëshoj certifikatën e kompetencave në monitorim të prokurimit.

Të gjithë individët mund të shfrytëzojnë këto certifikata në të ardhmen për të dëshmuar kompetencën e tyre në monitorim të prokurimit publik nga Civikos në kuadër të Projektit të financuar të USAID Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse. Certifikatat do të identifikohen në web-faqen [www.monitoro-raporto.net](http://www.monitoro-raporto.net).